

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE

NR 4113 REP
NR 2068 KOL



**KONTRATE PER TRANSFERIMIN E PJESEVE
TE KAPITALIT TE SHOQERISE "GEOSAT GROUP" sh.p.k**

Sot ne daten 22.11.2005 (dymije e pese) perpara meje MIMOZA SADUSHI, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " Vaso Pasha", pall. 13, u paraqiten personalisht palet :

PALA SHITese: PARIDE BOSCHETTI, I biri I shtetas Italian, I biri I Nazzarenos, lindur ne Rimini, lindur me 05.11.1963, banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar, me pasaporte 159604.

Dhe

PALA BLERESE: MAJLINDA NIKOLLI e bija e Markut ,lindur me 14.06.1972 ne Tirane dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi juridike per te vepruar me nr pasaporte 1253890.

MEQENESE:

- a) Shitesi zoteron 100% te kuotave te shoqerise "GEOSAT GROUP" sh.p.k. (Shoqeria), shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar dhe qe ushtron aktivitetin e saj ne baze te legjislacionit shqiptar, regjistruar ne regjistrin tregtar me vendimin nr. 27323 Date 04.04.2002.
- b) Bleresi deshiron te bleje kuotat ne masen 100% te zoteruara nga Shitesi qe perfaqesojne 100% te pjeseve te kapitalit te Shoqerise:
- c) Shitesi eshte dakort ti shese Bleresit kuotat qe ai zoteron ne Shoqerine " Geosat Group" shpk.

Palet bien dakort per sa me poshte vijon:

1. Objekti I Kontrates

- 1.1 Sipas kushteve te parashikuara ne kete Kontrate, Shitesi bie dakort te transferoje tek Bleresi dhe ky I fundit bie dakort te bleje kuotat qe zoterohen nga shitesi qe perfaqesojne 100% te Kapitalit te shoqerise " Geosat Group" sh.p.k.

2. Cmimi I Shitjes

- 2.1 Pjeset e kapitalit shiten (transferohen) kundrejt cmimit te pergjithshem prej 100.000 leke (njeqind mije leke), vlere per te cilen Bleresi deklaroi se nuk ka asnje pretendim.

2.2 Çmimi i mesiperm i shitjes i është paguar Shitesit me pagese në dorë përpara nënshkrimit të kësaj kontrate jashtë zyres noteriale.

3. Te ndryshme

3.1 Pas shitjes (transferimit) të pjesëve tek Bleresi, Znj. MAJLINDA NIKOLLI bëhet pronare e 100% të kapitalit të Shoqërisë "Geosat Group" sh.p.k.

3.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitesi humbet çdo të drejtë pronësie si dhe çdo të drejtë tjetër përse i përket pjesës së kuotave që i transferon Bleresit dhe Bleresi bëhet pronar i ligjshëm i 100% të kapitalit të Shoqërisë, duke mbetur ortakë e vetme dhe administratore në këtë shoqëri.

4. Baza Ligjore

4.1 Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës Shqiptare dhe të ligjit 7638 datë 19.12.1992 "Për shoqëritë tregtare"

4.2 Kjo kontratë hartohet në 4 (kater) kopje, një kopje për zyren e regjistrimit tregtar të shoqërive tregtare, një kopje për tu depozituar tek noteri dhe një kopje për secilin nga palet.


Kjo kontratë pasi u lexua për mëtej Noterit, u gjet në përputhje me vullnetin e lirë e të plotë të paleve dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre në praninë time dhe unë Noteri e vërtetoj këtë sipas ligjit.

PALA SHITESE

PALA BLERESE

PARIDE BOSCHETTI

Boschetti, Paride



MAJLINDA NIKOLLI

Majlinda Nikolli

